

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6572
E mërkurë, 30 mars 2022
çmimi 0.40 €

Një vit nga fillimi
i vaksinimit kundër
Covidit në Kosovë FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATON KLINAKU FAQE 4-5

VETERANËT E UÇK-së PRESIN RRITJE TË PENSIONEVE

- Institucionet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë
për bashkëlufëtaret tanë në Hagë



Ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se nuk është i nevojshëm të bëhet temë diskutimi rishikimi i listave të veteranëve përderisa kjo çështje është në gjykatë. Ai ka bërë me dije se në takimin e fundit që kanë pasur me kryeministrin Kurti kanë kërkuar nga ai ta presë përfundimin e procesit gjyqësor për këtë çështje. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" Klinaku ka thënë se veteranët e UÇK-së dhe familjarët e tyre janë duke u ballafaquar me mungesë të punësimit. Në këtë kontekst ai ka thënë se me rritjen e pagës minimale presin të rriten edhe pensionet e veteranëve të UÇK-së. Ndërsa sa i përket Gjykatës Speciale, Klinaku ka thënë se institucionet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për të gjithë luftëtarët e lirisë të cilët janë në Hagë

OPINION

GJATË LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE KUFIJTË POLITIKË
U BARAZUAN ME ATA ETNIKË F. 6



Nga Dr. Haqif MULLIQI dhe Dr. Daut DAUTI

THEMELIMI I GRUPEVE PËR
MBIKËQYRJE, CENIM I
PAVARËSISË SË BQK-së F. 6

Shkruan: Safet
GËRXHALIU



AKTUALE



KONJUFCA: KOSOVA DHE
SHQIPËRIA PËRBALLË
SFIDAVE DUHET TË JENË AFËR
NJËRA-TJETRËS F. 7

TË ADRESOHET ME URGJENCË
DHUNA NDAJ FËMIJËVE F. 3

EKONOMI



OSMANI TAKON KOMUNITETIN
E BIZNESIT NË KATAR F. 8

Ukraina jep
propozime të
reja për arritjen
e paqes FAQE 2



KËSHILLI DREJTUES I PDK-SË I HAP
RRUGË THEMELIMIT TË KABINETIT
TË QEVERISJES SË MIRË FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina jep propozime të reja për arritjen e paqes



ANKARA, 29 MARS - Delegacioni nga Ukraina dhe ai nga Rusia janë takuar dje në Stamboll. Sipas nikoqires së takimit, Turqisë, ishte raundi me më së shumti përparim deri më tani në procesin e paqes.

Ukraina gjatë këtij takimi tha se ka propozuar që të miratojë një status neutral në këmbim të garancive të sigurisë. Këto propozime janë prezantuar gjatë bisedimeve me Rusinë që u mbajtën të martën në Turqi, që nënkupton se Kievi nuk do t'i bashkohej NATO-s apo që në bazat e saj nuk do të vendoseshin ushtarë të aleancës së NATO-s, thanë negociatorët ukrainas.

Propozimet që, po ashtu, përfshijnë një periudhë 15-vjeçare të konsultimeve për statusin e Gadishullit të aneksuar të Krimesë, do të mund të zbatoheshin vetëm në rastin e një armëpushimi të plotë, thanë negociatorët për gazetarët në Stamboll.

Propozimet janë më të detajuara dhe më konkretet që Ukraina i ka paraqitur publikisht. Ato, gjithashtu, parashikojnë garanci të sigurisë në linjë me artikullin 5 të NATO-s, që është një klauzolë për mbrojtje kolektive.

Polonia, Izraeli, Turqia dhe Kanadaja mund të jenë garantuesit e mundshëm për këto propozime. "Nëse ne arrijmë t'i konsolidojmë këto

provizione kyçe, dhe për ne kjo është më e rëndësishmja, atëherë Ukraina do të jetë në pozitë që ta rregullojë statusin aktual si një shtet që nuk është pjesë e bllokut dhe pa armë bërthamore, në formë të një neutraliteti të përhershëm", tha negociatori Oleksander Chaly. "Ne nuk do ta lejojmë hapjen e bazave të huaja ushtarake në vendin tonë e as nuk do të bëjë vendosjen e kontingjenteve ushtarake në territorin tonë dhe nuk do të bëhemi pjesë e aleancave ushtarake-politike", tha ai për televizionin kombëtar ukrainas, duke shtuar se stërvitjet ushtarake në territorin e tyre të mbahen me pëlqimin e shteteve garantuuese.

Sipas negociatorëve ukrainas, këto propozime janë të mjaftueshme që presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky dhe ai rus Vladimir Putin të takohen. Por, pala ukrainase tha se për këtë temë po pret përgjigjen e palës ruse. Gjatë takimit në Stamboll, Ukraina kërkoi një marrëveshje armëpushimi që nuk do ta komprometonte territorin as sovranitetin e vendit.

Sipas nikoqires së këtij takimi, Turqisë, bisedimet në Stamboll shënojnë përparimin më të rëndësishëm në procesin e paqes deri më tani, deklaroi ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu.

Cavusoglu tha se Turqia mirëpret faktin që palët kanë arritur kompromis dhe gjuhë të përbashkët për një sërë çështjesh dhe se shpreson që lufta të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Ai, po ashtu, tha se për "çështjet më të vështira" pritet të diskutohen midis ministrave të jashtëm ukrainas dhe rusë në një takim tjetër, duke mos e përjashtuar mundësinë e një takimi mes presidentëve të dy shteteve.

Raundet e mëhershme të bisedimeve, si ato sy më sy, por edhe ato përmes formateve online, kanë dështuar të arrijnë ndonjë përparim.

Këto njoftime vijnë teksa zëvendësministri i Mbrojtjes i Rusisë, Alexander Fomin, tha se Rusia do ta "zvogëlojë në mënyrë drastike" aktivitetin ushtarak jashtë Kievit dhe Çernihivit, ka raportuar agjencia ruse e lajmeve "Tass".

Erdogani bën thirrje për armëpushim të menjëhershëm në Ukrainë

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, tha se bisedimet midis negociatorëve rusë dhe ukrainas, që mbahen sot në Stamboll, mund të hapin rrugë për takimin e liderëve të Ukrainës dhe Rusisë.

Në një adresim para

negociatorëve, Erdogan tha se është koha që bisedimet të japin rezultate konkrete dhe bëri thirrje për armëpushim të menjëhershëm, duke shtuar se "ndalja e kësaj tragjedie" varet nga të dyja palët.

Erdogani tha se si presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, ashtu edhe ai rus, Vladimir Putin, ishin "miq të çmuar".

Presidenti turk tha se Ukraina dhe Rusia kanë "shqetësime legjitime", por shtoi se ka ardhur koha që bisedimet të japin rezultate konkrete. Ai, po ashtu, tha se "paqja e drejtë" nuk ka humbës dhe se vazhdimi i konfliktit nuk i shkon përshtati askujt. "Në një moment kaq kritik ne jemi të kënaqur t'i mirëpresim dhe të kontribuojmë në përpjekjet e juaja për të vendosur paqe", tha ai. "Shpresoj që takimi ynë dhe diskutimet tona të shkojnë në favor të shteteve tuaja, të rajonit tonë dhe të gjithë njerëzimit", u shpreh Erdogan.

Ky është takimi i dytë që mbahet në Turqi, pasi në fillim të marsit kryediplomatët ukrainas dhe rusë u takuan në Antali, por takimi i tyre përfundoi pa ndonjë rezultat konkret.

Palët kanë mbajtur takime edhe në Bjellorusi dhe përmes platformave online, takime që kanë për qëllim t'i japin fund pushtimit të paprovokuar rus të Ukrainës që nisi më 24 shkurt.

Biden: Komentet ndaj Putinit, "zemërim moral"

Presidenti amerikan Joe Biden u ka thënë gazetarëve më 28 mars se ai nuk kërkon falje që ka thënë se presidenti rus Vladimir Putin nuk duhet të mbetet në pushtet. Ai ka bërë deklaratat për presidentin rus gjatë mbajtjes së një fjalimi në Varshavë më 26 mars, dhe fjalët e tij janë interpretuar se Bideni ka bërë thirrje për ndryshim të regjimit.

Shtëpia e Bardhë dhe sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, kanë sqaruar deklaratat gjatë fundjavës dhe vetë Bideni ka thënë më 28 mars se komentet kanë qenë shprehje e "zemërimit moral" dhe nuk synojnë politikë të re.

Bideni ka thënë se "nuk ka qenë duke artikuluar ndryshim të politikave", mirëpo ka thënë se zemërimi i tij ka ardhur menjëherë pasi ka vizituar refugjatët ukrainas në Poloni. "Askush nuk e beson se unë po flisja për rrëzimin e Putinit. Gjëja e fundit që dua është që të përfshihem në luftë tokësore me Rusinë", ka theksuar Biden. Ai ka mohuar se fjalët e tij ndaj Putinit dhe qëndrimin në pushtet mund të konsiderohen nga Rusia si propagandë dhe ka theksuar se NATO-ja nuk ka qenë kurrë më e bashkuar.

AKK-ja: Pasurinë nuk e kanë deklaruar edhe 1 426 zyrtarë publikë

PRISHTINË, 29 MARS (ER) - Kanë mbetur edhe dy ditë nga përfundimi i përbushjes së obligimeve ligjore për deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë, por obligimit ligjor nuk i janë përgjigjur edhe rreth 1 426 (29.93 për qind) zyrtarë publikë. Secilit zyrtar të lartë publik i kërkohet deklarimi i saktë dhe brenda

afatit ligjor i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave dhe çfarëdo dobie tjetër materiale ose i detyrimeve financiare të realizuara brenda apo jashtë vendi.

Agjencia Kundër Korrupsionit ka alokuar të gjitha burimet e nevojshme njerëzore dhe materiale për të përmbyllur me sukses këtë proces.

Agjencia Kundër Korrupsionit edhe një herë ua ka rikujtuar zyrtarëve të lartë publikë, që tashmë nuk e kanë kryer obligimin ligjor, që deklarimin e pasurisë ta bëjnë saktë dhe me kohë, në të kundërtën AKK-ja detyrohet të veprojë në pajtim me nenin 430 të Kodit Penal të Kosovës.



Një vit nga fillimi i vaksinimit kundër Covidit në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 MARS - Ndonëse e ka filluar e fundit në rajon vaksinimin, Kosova ia ka dalë që të ketë shkallë më të lartë të vaksinimit se shtetet e rajonit, përfshirë Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Bosnjë Hercegovinën, Bullgarinë dhe shtete të tjera, ndërsa ka shkallë të krahasueshme me disa shtete të Evropës.

Me mbi 1 820 000 doza të administruara, vaksinimi te popullata mbi 18 vjeçe në Kosovë ka arritur në 70 për qind me një dozë dhe 63.4 për qind me dy doza.

Te popullata mbi 12 vjeçe janë vaksinuar 62.7 për qind me një dozë dhe 57.1 për qind me dy doza. Sfidë mbetet vaksinimi me dozën e tretë, ku vetëm rreth 7 për qind e popullatës mbi 12 vjeçe e kanë marrë atë.

Një vit pas, Ministria e

Shëndetësisë i falënderon të gjithë ata që kanë qenë pjesë e procesit të vaksinimit kundër Covid-19 përmes Komitetit për Imunizim, ekipit menaxhues dhe ekipeve vetëmohuese të vaksinimit në 30 komuna të Kosovës për kontributin që kanë dhënë për shpëtimin e shumë jetëve të njerëzve. Gjithashtu, edhe donatorët që përmes mekanizmave të ndryshëm ndihmuan Kosovën për sigurimin e vaksinave kundër Covid-19 dhe qëndrueshmërinë e suksesin e këtij procesi.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të martën se në 24 orët e fundit janë dhënë 272 doza të vaksinës kundër Covidit. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 821 540 doza të vaksinës.

Deri më sot 820 146 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 99 870 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



32 raste të reja me Covid në orët e fundit

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se pas 969 testimeve, 32 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shënuar 36 qytetarë, ndërsa numri i

përgjithshëm i të shëruarve është 223 684. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 593.

Të adresohet me urgjencë dhuna ndaj fëmijëve



PRISHTINË, 29 MARS (ER) - Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, dhe koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF kanë mbajtur tryezën e diskutimit me temën "Integrimi i politikave dhe shërbimeve për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve, me fokus në shkollë".

Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi mbi modelet e integritimit të politikave dhe shërbimeve për parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve. Disa prej rekomandimeve kryesore që u adresuan nga pjesëmarrësit në

këtë tryezë ishin rritja e raportimit të rasteve të dhunës, rritja e monitorimit dhe llogaridhënies të ofruesve të shërbimeve, ofrimi i shërbimeve të integruara në mes të sektorit të arsimit, shërbimeve sociale dhe shëndetësisë, rritja e numrit dhe kapaciteteve të psikologëve, pedagogëve dhe stafit mbështetës në shkolla, miratimi i grantit të veçantë për shërbime sociale dhe aplikimi i programeve për prindërim të mirë.

Në këtë tryezë u tha se duhet të adresohet me urgjencë dhuna ndaj fëmijëve.

Fjalë rasti në këtë tryezë mbajtën Ardian Gola, kryetar i Komisionit

për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, Arbërie Nagavci, ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Larissa Bruun, Zyra e UNICEF-it në Kosovë dhe Petrit Tahiri, anëtar i Bordit të KOMF-i.

Ndërsa pjesë e panelit të diskutimit ishin Eldin Gashi, nxënës, Ymret Rushiti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Kosovës, Samir Shahini, kryetar i Kolegjiut për Arsim - Asociacioni i Komunave, Blerim Shabani, kryetar i Lidhjes së Qendrave për Punë Sociale dhe Nilgyn Kosova nga Policia e Kosovës.

U vazhdohet paraburgimi Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit

Hagë, 29 mars - Dhoma e Apelit në kuadër të Gjykatës Speciale ua ka refuzuar ankesën për lirim nga paraburgimi, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Ankesa e

tyre kishte të bënte me vendimin e gjykatës për paraprak për refuzimin e liritimit nga paraburgimi. Mirëpo, paneli i Apelit, i përbërë nga gjyqtarët Kai

Ambos, Emilio Gatti, Michele Picard, ka vendosur që ta hedhë poshtë ankesën duke lënë kështu në paraburgim dy nga katër ish-krerët e UÇK-së që po

gjykohen në Hagë. Paneli i Apelit të kësaj gjykate nuk e ka publikuar ende vendimin për Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin.





FLET PËR "EPOKËN E RE", FATON KLINAKU

Veteranët e UÇK-së presin rritje të pensioneve

- Institucionet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për bashkëluftëtarët tanë në Hagë

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se nuk është i nevojshëm të bëhet temë diskutimi rishikimi i listave të veteranëve përderisa kjo çështje është në gjykatë. Ai ka bërë me dije se në takimin e fundit që kanë pasur me kryeministrin Kurti kanë kërkuar nga ai ta presë përfundimin e procesit gjyqësor për këtë çështje. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" Klinaku ka thënë se veteranët e UÇK-së dhe familjarët e tyre janë duke u ballafaquar me mungesë të punësimit. Në këtë kontekst ai ka thënë se me rritjen e pagës minimale presin të rriten edhe pensionet e veteranëve të UÇK-së. Ndërsa sa i përket Gjykatës Speciale, Klinaku ka thënë se institucionet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për të gjithë luftëtarët e lirisë të cilët janë në Hagë

EPOKA E RE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 29 MARS - Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Faton Klinaku, ka thënë se veteranët e luftës çlirimtare janë duke u ballafaquar me probleme të shumta, sidomos me mungesë të punësimit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Klinaku ka thënë se institucionet e Kosovës nuk janë duke e përkrahur rehabilitimin e veteranëve të UÇK-së. "Përveç të tjerash, ashtu si edhe populli në përgjithësi, veteranët janë duke u ballafaquar edhe me mungesë të

punësimit për vete dhe familjarët e tyre", ka deklaruar Klinaku, duke shtuar se veteranët e UÇK-së presin rritje të pensioneve. "Veteranët e luftës presin që me rritjen e pagës minimale t'u rritet edhe pensioni, sepse kjo është e përcaktuar me ligj", ka thënë Klinaku. Ndërsa duke komentuar deklaratën e kryeministrin Albin Kurti për verifikimin e listave të veteranëve të UÇK-së, Klinaku ka thënë se nuk ka nevojë të bëhet temë kjo çështje pasi gjykata është duke u marrë me një gjë të tillë. Ai ka thënë se në takimin e fundit që kanë pasur me kryeministrin Kurti i kanë kërkuar që ta presë përfundimin e procesit gjyqësor për veteranët e UÇK-së.

"Kryeministrin Kurti i kemi thënë që duhet pritur përfundimin e procesit gjyqësor, por edhe nëse vendoset që të krijohet komision tjetër qeveritar, ai duhet t'i thërrasë komandantët e strukturave të UÇK-së për ta bërë këtë rishikim", është shprehur Klinaku. Në këtë intervistë Klinaku ka folur edhe për Gjykatën Speciale dhe ish-drejtesit e UÇK-së që janë duke u ballafaquar me drejtësinë në Hagë. Ai ka thënë se nga themelimi këtë gjykatë e shohin si politike. "Gjykata Speciale vetëm themelimin e ka në Kuvend të Kosovës, por nuk ka të bëjë fare me Kosovën, dhe ashtu siç e kemi parë në kohën e themelimit të saj, e shohim edhe

tani si gjykatë politike e jo të drejtësisë", ka thënë Klinaku. Në këtë kontekst, Klinaku ka shprehur kritika edhe ndaj institucioneve të Kosovës, të cilat, sipas tij, duhet të bëjnë më shumë për të gjithë luftëtarët e lirisë të cilët janë në Hagë. "Institucionet, përveç pagesave që ua bëjnë avokatëve mbrojtës të të akuzuarve dhe vizitave të familjarëve të tyre, konsideroj se duhet bërë më shumë. Nuk është ndërhyrje në drejtësi kur ngritet zëri dhe kërkohet vendosmërisht që bashkëluftëtarëve tanë në Hagë të mos u shkelen të drejtat e njeriut që i kanë të garantuara në Kushtetutë", është shprehur Klinaku.

"Epoka e re": Z. Klinaku, me çfarë vështirësish janë duke u ballafaquar veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)?

Klinaku: Veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë kaluar një luftë e cila i ka edhe pasojat e veta. Përveç të tjerash, ashtu si edhe populli në përgjithësi, veteranët janë duke u ballafaquar edhe me mungesë të punësimit për vete dhe familjarët e tyre.

"Epoka e re": A janë duke ju përkrahur institucionet e Kosovës për realizimin e kërkesave që kanë veteranët?

Klinaku: Institucionet e Kosovës janë duke i kryer obligimet ligjore që i kanë ndaj veteranëve siç është pagesa e pensioneve. Në kërkesat e tjera, siç mund të jetë rehabilitimi i tyre, ende nuk po kemi përkrahje.

"Epoka e re": Para disa ditësh kryeministri Kurti ka përmendur mundësinë e rishikimit të listave të veteranëve të UÇK-së. Si e keni parë këtë deklaratë të kryeministrin?

Klinaku: Ka pasur një komision qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe verifikimi është bërë në zyrat e qeverisë nga komandantët e atëhershëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Duke pasur dyshime në këtë, thirrjet që ne si organizatë e veteranëve i kemi bërë, prokuroria ka filluar hetimin dhe tani lënda është në gjykatë. Nuk ka nevojë të bëhet

temë diskutimi kjo çështje përderisa kemi një proces gjyqësor që ende nuk ka përfunduar.

“Epoka e re”: Pas kësaj deklarate ju keni pasur një takim me Kurtin. Çfarë keni biseduar me të?

Klinaku: Edhe në takim kryeministrit Kurti i kemi thënë që duhet pritur përfundimin e procesit gjyqësor, por edhe nëse vendoset që të krijohet komision tjetër qeveritar, ai duhet t'i thërrasë komandantët e strukturave të UÇK-së për ta bërë këtë rishikim.

“Epoka e re”: Qeveria e Kosovës është duke punuar për rritjen e pagës minimale në Kosovë dhe miratimin e Ligjit për Paga. Cilat janë kërkesat e veteranëve të UÇK-së sa iu përket pensioneve që ata marrin aktualisht?

Klinaku: Veteranët e luftës presin që me rritjen e pagës minimale t'u rritet edhe pensioni, sepse kjo është e përcaktuar me ligj. Me pensionin aktual që e kanë, në këtë kohë të shtrenjtimit të mëdha, ata nuk mund t'i mbulojnë as shpenzimet minimale për jetesë.

“Epoka e re”: Z. Klinaku, kohën e fundit janë shtuar zërat për zhbërjen e Gjykatës Speciale. Si

jeni duke e parë punën e kësaj gjykate?

Klinaku: Ju e dini që ne si OVLUÇK e kemi kundërshtuar themelimin e kësaj gjykate, duke kërkuar që të themelohet gjykatë vendore, që t'i hetojë të gjitha krimet e luftës. Në Kosovë ka pasur krime dhe masakra që i ka shkaktuar Serbia dhe serbët ndaj shqiptarëve, dhe ato nuk janë hetuar e as nuk po hetohen nga drejtësia ndërkombëtare. Gjykata Speciale vetëm themelimin e ka në Kuvend të Kosovës, por nuk ka të bëjë fare me Kosovën, dhe ashtu siç e kemi parë në kohën e themelimit të saj, e shohim edhe tani si gjykatë politike e jo të drejtësisë.

“Epoka e re”: A janë në nivel të detyrës institucionet e Kosovës për ofrimin e përkrahjes për ish-drejtuessit dhe luftëtarët e UÇK-së të cilët janë në Hagë?

Klinaku: Institucionet, përveç pagesave që ua bëjnë avokatëve mbrojtës të akuzuarve dhe vizitave të familjarëve të tyre, konsideroj se duhet të bëjnë më shumë. Nuk është ndërhyrje në drejtësi kur ngritet zëri dhe kërkohet vendosmërisht që bashkëluftëtarëve tanë në Hagë të mos u shkelen të drejtat e njeriut që i kanë të garantuara në Kushtetutë.



Kurti: Kosova e sheh Norvegjinë si shembull se si ndërtohet një shoqëri e drejtë

PRISHTINË, 29 MARS (ER) - Në ditën e dytë të vizitës zyrtare në Norvegji, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u prit nga kryeministri i Norvegjisë, Jonas Gahr Store, në rezidencën e tij.

Kryeministri Kurti e falënderoi për mikpritjen e ngrohtë dhe e uroi për detyrën e tij të re. “Norvegjia është mike dhe partnere e Kosovës dhe popullit të saj, që është dëshmuar e tillë përgjatë gjithë historisë së re të Republikës së Kosovës. Ajo ishte ndër vendet e para që njohën pavarësinë e Republikës së Kosovës dhe ishte ndër vendet e para që e ndihmuan Kosovën me pajisje mjekësore në ballafaqimin e saj me pandeminë”, ka thënë ai.

Kryeministri Kurti tha se për këtë Kosova dhe populli i Kosovës janë thellësisht falënderues. “Kosova e sheh Norvegjinë si shembull se si mund të ndërtohet një shoqëri e drejtë dhe me prosperitet duke investuar në edukim, mirëqenie sociale dhe tash në ekonomi të gjelbër. Të tri këto janë prioritete edhe të qeverisë sonë”, u shpreh kryeministri Kurti, duke marrë parasysh edhe indikatorët pozitivë në ekonomi, por edhe ata në demokraci.

“Është koha që ta thellojmë bashkëpunimin dhe rrisim lidhjet tona ekonomike”, ka shtuar kryeministri Kurti.

Ndërkaq kryeministri i Norvegjisë, Jonas Gahr Store, i

uroi kryeministrit Kurti mirëseardhje në Norvegji. Ai tha se është i interesuar për reformat që Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar të ndërmarë dhe është i gatshëm ta rrisë bashkëpunimin bilateral ndërmjet dy vendeve. Ai, po ashtu, shprehu interesim për propozimet konstruktive dhe progresive për bashkëpunim rajonal që ka bërë Qeveria e Kosovës. Në takim, gjithashtu, u diskutua për rëndësinë e raporteve të mira fqinjësore ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor si dhe për invazionin dhe agresionin e paprovokuar ushtarak rus në Ukrainë, të cilin e dënuan ashpër të dy kryeministrat.



Komisioni i Jashtëm i Kosovës dhe ai i Shqipërisë bashkërendojnë aktivitetet

PRISHTINË, 29 MARS (ER) - Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë i Kuvendit të Kosovës ka pritur të martën në takim Komisionin për Politikën e Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë, të prirë nga Mimi Kodheli, kryetare e këtij komisioni.

Ky takim, i cili u zhvillua në një frymë vëllazërore, u kryesua nga Haki Abazi, kryetar i Komisionit, i cili, pasi falënderoi mysafirët për vizitën, vuri në pah nevojën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve ndërmjet të dy komisioneve.

Abazi nënvizoi se “pavarësisht prej çështjeve që mund të mos pajtojmë, ato që na bashkojnë mbesin dominuese dhe të patjetërsueshme në rrugëtimin tonë të përbashkët në procesin e integritimit euroatlantik”.

Edhe kryetarja e Komisionit të Kuvendit të Shqipërisë, Mimi Kodheli, ka vlerësuar lart bashkëpunimin e gjertanishëm ndërmjet të dy vendeve, me theks të veçantë atë ndërmjet të dy komisioneve. Ajo u shpreh e bindur se ky bashkëpunim do të vijojë edhe në të ardhmen, sidomos në fushën e diplomacisë parlamentare.

Në vijim të takimit temat që dominuan gjatë debatit ishin: lufta në Ukrainë dhe ndikimi i saj në rajon, integritet euroatlantike të rajonit, bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë, si dhe zbatimi i marrëveshjeve të arritura ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Sa i përket agresionit të Rusisë në Ukrainë, bashkëbiseduesit vlerësuan se efektet e saj janë duke u ndierë në ngritjen e



çmimeve në shumë artikuj ushqimorë, në naftën dhe derivatet e saj, si dhe në furnizimin me energji elektrike. Ndërkaq shprehën optimizëm se marrëveshjet e nënshkuara ndërmjet qeverive përkatëse do të gjejnë zbatim të tërësishëm gjatë një së ardhmeje të afërt.


Duke analizuar mundësitë e bashkëpunimit edhe të mëtutjeshëm ekonomik, përfaqësuesit e të dy komisioneve vlerësuan se ai duhet të jetë edhe më i madh duke hequr barrierat që mund ta pengojnë atë. Sa i përket çështjes së sigurisë, ndërkaq, u vlerësua se

anëtarësimi i Shqipërisë në NATO dhe prania e KFOR-it në Kosovë janë garanci e një stabiliteti për të dyja vendet por, megjithatë, u tha në takim, situata duhet të vlerësohet me kujdes, në një kohë kur ende nuk dihet se si do të përfundojë agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës.

HISTORIOGRAFI

Gjatë Luftës së Dytë Botërore kufijtë politikë u barazuan me ata etnikë

Kufijtë veriorë të Shqipërisë 1942-1944 sipas burimeve diplomatike angleze



Nga Dr. Haqif MULLIQI dhe Dr. Daut DAUTI

1. Në fillim të vitit 1940, para se Italia të futej në luftë WO (Ministria e Luftës e Britanisë së Madhe) mori përsipër që ta ndihmonte organizimin e rezistencës në Shqipëri. Shërbimi SIS (Shërbimi Sekret Informativ i B. së Madhe) në seksionin D përfshinte Shqipërinë. Ky seksion udhëhoq nga zoti Julian Emery, i cili në këtë kohë gjendej në Jugosllavi, prej nga mëtohej depërtimi në Shqipërinë e okupuar nga Italia fashiste që nga prilli i vitit 1939. Ky veprim u përqendrua në tri punkte. Punkti i parë ishte Mali i Zi, prej nga depërtohej në Shqipërinë e Veriut, e i cili punkt drejtohej nga Jovan Gjinoviqi. Punkti i dytë ishte ai i Kosovës dhe udhëhoq nga Gani be Kryeziu. Ndërsa, në Maqedoni, në punktin e krijuar vepronte kolonel Kokoshi, i cili e kishte selinë në Dibër. Kështu pra u krijua një gjysmëhark rreth kufirit të Shqipërisë i cili ishte kusht i domosdoshëm i mbledhjes së informatave nga të cilat do të përfitonin edhe oficerët e misionit ushtarak britanik të cilët më vonë do të paraqiteshin në Shqipëri. Kështu, gjatë vitit 1941 në Londër arrinin raporte të shpeshta të cilat flisnin se shqiptarët ndërmerrnin aksione të ndryshme kundër forcave okupuese fashiste. Gjatë po këtij viti në Foreign Office (Ministrinë e Jashtme të B. së Madhe) nisën të arrinin letra të shumta nga personalitetet e shumta të cilat sugjeronin qeverinë e këtij vendi se do të duhej të bëhej të paktën një deklaratë nga e cila do të inkurajoheshin shqiptarët. Mirëpo, qeveria e Lartmadhërisë së Tij nuk ndërmori ndonjë veprim të vetëm që t'i kënaqte sadopak ata që i shkruanin. Gjatë po të njëjtë vit (1941) ishte e hetueshme edhe një formë e presionit e cila i bëhej Londrës për

njohjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe të sovranit të saj, Mbretit Zog. Por Londra nuk u nënshtrohej këtyre formave të trysnisë dhe nuk e përfillte dot asnjërin nga këto dy kërkesa.

Mirëpo, sipas dokumenteve të Foreign Office-s, duket se çështja e pavarësisë së Shqipërisë nga ana e qeverisë së Britanisë së Madhe nisi të lëvizë diku nga muaji tetor i vitit 1941. Kryesuesi i Departamentit Jugor, zoti Pierr Dikson, më 9 tetor të vitit 1941 deklaroi: "Gjatë kësaj kohe është plotësisht e pamundshme të vendoset se a do të jetë e këshillueshme që të krijohet një Shqipëri e pavarur ose jo, dhe se a do të ketë rëndësi parimi etnik në fund të kësaj lufte".

Raporti i Diksonit tutje përshkruhet nga pasiguritë e shumta të cilat i imponuan faktorët e ndryshëm në raport me këtë çështje, kështu që ai i preferon qeverisë britanike që lidhur me këtë çështje të mos ngatërrohet me qeveritë e Greqisë dhe të Jugosllavisë.

Mirëpo, kur ministri i jashtëm britanik, zoti Entoni Idën, nga fundi i vitit 1941 vizitoi Moskën, atëherë çështja e pavarësisë së Shqipërisë sikur nisi të qartësohet. Traktati anglo-sovjetik përfundoi në Londër më 26 maj të vitit 1942 me rastin e vizitës që i bëri Molotovi kryeqendrës së Mbretërisë së Bashkuar. Pika kyçe rreth së cilës u morën vesh këto dy shtete ishte "pakti njëzetvjeçar për ndihma reciproke, por i cili tekst linte jashtë çfarëdo përmendjeje problemet rreth kufijve territorial". Por, më e rëndësishmja për shqiptarët nga ky takim i nivelit të lartë ishte fakti se njëra ndër pikat e traktatit të lartpërmendur Shqipërinë e shihte si shtet të pavarur.

Bazë tjetër që siguronte një lëvizje më të shpejtë dhe më të sigurt

drejt njohjes së shtetit shqiptar ishte edhe Karta e Atlantikut e gushtit të vitit 1941 nga e cila rezultonte edhe deklarata e Uashingtonit e 26 vendeve e 1 janarit të vitit 1942. Këto dokumente të rëndësishme premtinin vetëvendosjen dhe rivendosjen e sovranitetit për ato vende që ishin okupuar me forcë. Në bazë të kësaj, Abisinisë i qe kthyer pavarësia. Mirëpo, përkundër këtyre dokumenteve, qeveria e Britanisë së Madhe manifestonte shqetësimet e saj në rastin e Shqipërisë, duke konsideruar se çështja e saj ishte një rast fare tjetër dhe mjaft i koklavitur.

Gjatë vitit 1942 Diksoni bëri edhe një raport i cili u miratua edhe nga Sër Aleksandër Kadogan, raport ky i cili në një masë të konsiderueshme frenoi aspiratat gllabëruese të Greqisë dhe të Jugosllavisë ndaj territoreve shqiptare. Raporti i Diksonit i vitit 1942 përbëhej nga 5 pika. Me to parashihej që qeveria e Lartmadhërisë së Tij duhej të dilte me një deklaratë publike në lidhje me ardhmërinë e Shqipërisë. Kjo deklaratë duhej bërë në Parlament (në formë pyetje përgjigje), me ç'rast do të manifestoheshin simpatitë për fatin e shqiptarëve si viktimat të fashizmit italian. Këtu, gjithashtu duhej deklaruar edhe për formën e regjimit dhe për qeverinë shqiptare, si një çështje për të cilën do të vendoste vetë populli shqiptar pas përfundimit të luftës. Po ashtu theksohej se, para se të nxirrej kjo deklaratë, do të duhej informuar qeverinë greke dhe atë jugosllave, ndërsa pas nxjerrjes së saj do të duhej informuar për këtë edhe Mbretin Zog, por në atë mënyrë që ky këtë mos ta kuptojë si një përkrahje të drejtpërdrejtë për kthimin e tij në fronin e Shqipërisë, por që, nga ana tjetër, të mos kuptohet as si kundërshtim i një gjëje të tillë, në mënyrë që çështja e tij të mbetet si një çështje e hapur deri atëherë kur ai të paraqitet vetë para popullit shqiptar, pra pas përfundimit të luftës. Po ashtu, raporti i Diksonit parashihte që, nëpërmjet Bi-Bi-Si-së, të ushtrohej një propagandë e cila do t'u epte zemër lëvizjeve dhe rezistencës së shqiptarëve kundër italianëve.

2) Pas lëvizjeve dinamike që u bënë në botë, e cila pothuaj e tëra ishte përfshirë në luftë dhe pas lëvizjeve të rezistencës që bëheshin në Shqipëri, veçmas

duke pasur parasysh situatën në Ballkan, më 13 dhjetor të vitit 1942 qeveria britanike proklamoi njohjen e pavarësisë së Shqipërisë. Madje u bë me dije se kjo njohje u bë në pajtim të plotë me forcat aleate të luftës. Tri ditë më parë (10 dhjetor 1942) sekretari amerikan i shtetit, zoti Kardell Hall, i premtoi popullit shqiptar ndihmën e SHBA-ve në luftën e tij për çlirim kundër okupatorit italian.

Më 17 dhjetor të vitit 1942 ministri i jashtëm i Britanisë, z. Antonildën, në dhomën e komunave të Parlamentit të këtij shteti doli me këtë deklaratë: "Format e regjimit dhe të qeverisimit që do të paraqiten në Shqipëri do të jenë çështje për të cilat populli shqiptar do të vendosë në fund të luftës, ndërsa çështja e kufijve të shtetit shqiptar do të jetë çështje e cila do të trajtohet në Konferencën e Paqes". Më 18 dhjetor të këtij viti pavarësinë e Shqipërisë do ta njoh Bashkimi Sovjetik. Kjo situatë e porsakrijuar kishte rëndësi kardinale jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për dy fqinjë e saj: Jugosllavinë dhe Greqinë. Por, edhe pse çështja e kufijve të Shqipërisë të vitit 1941 ishte e paqartë, megjithatë një gjë u sqarua plotësisht. Njohja e pavarësisë së Shqipërisë sikur i hodhi poshtë aspiratat e fqinjëve të pangopshëm të cilat i manifestonin madje edhe ndaj territorit të cilin Shqipëria e kishte brenda kufijve të vetë deri në vitin 1939.

3) Para dhe pas njohjes së pavarësisë së shtetit shqiptar, Foreign Office iu drejtua grupeve të ekspertëve për çështjet ballkanike, nëpër universitetet e Britanisë së Madhe që me studime më të thukëta të elaborohej problemi shqiptar. Kështu u bënë harta dhe variacione të ndryshme mbi mundësitë optimale të ekzistimit dhe të prosperimit të Shqipërisë, posaçërisht pas situatave që do të pasojnë pas përfundimit të luftës në Ballkan dhe më gjerë.

Më poshtë mund të vërehen disa aksente nga një dokument i këtillë i punuar për FO-në nga ekspertët e shquar për çështje ballkanike në Universitetin e Baliolit. Në këtë dokument parashihej që, pas përfundimit të armiqësive, Shqipëria të dalë si shtet i pavarur, mirëpo supozohej se mund të lindnin vështirësi për shkak të specifikave në regjion. Andaj, edhe sugjerohej se për këtë arsye do të

ketë nevojë që ky shtet të udhëhiqet dhe të kontrollohet nga "Këshilltarët e huaj". Gjithashtu, parashihej se Shqipëria mund të hyjë në bashkësinë e shteteve sovraane ballkanike ose mund ta refuzojë këtë bashkësi e cila ishte paraparë me marrëveshjen Greko-Jugosllave të 15 janarit të vitit 1942. Shqipëria, e cila, duke hyrë në union me Mbretërinë italiane e kishte humbur pavarësinë, sipas ekspertëve në fjalë, pas lufte do të duhej ta fillojë sendërtimin e saj nën mandatin e një apo dy superfuqive të pa interesuara për këtë vend. Për këtë gjë u propozuan Britania e Madhe ose SHBA-të, ose që të dyja këto së bashku. Punimet tjera paraqisnin harta të ndryshme të shtetit shqiptar, por nuk jepnin të kuptohej se çfarë do të jetë definitive para Konferencës së Paqes e cila, siç dihej, do të pasonte fill pas luftës. Gjithashtu, theksohej se në të ardhmen asnjë federatë apo konfederatë ballkanike nuk do të ketë sukses pa përfshirjen e Shqipërisë në të, duke pasur parasysh, në radhë të parë, rëndësinë vitale të Shqipërisë për mbrojtjen e Ballkanit nga agresioni eventual që mund t'i bëhej dhe se ky vend, sipas ekspertëve të Baliolit, paraqet "portën kryesore" për hyrje në gadishull.

Në "pretendimet territoriale të fqinjëve" në mënyrë të gjerë dhe objektive, ekspertët e Universitetit Baliol prezantojnë qëndrimet e shteteve përreth Shqipërisë. Sa u përket qëndrimeve jugosllave dhe greke, sipas këtyre ekspertëve, del se këto dy shtete angazhohen që Shqipëria të kthehet në suazat e kufijve të vitit 1939, madje duke mos fshehur pretendimet e tyre territoriale edhe për pjesë nga territoret brenda këtyre kufijve.

Vihej në pah se italianët e kishin përfutur simpatinë e shqiptarëve duke e kthyer pjesën më të madhe të territorit shqiptar që në dy konferencat e mëparshme (atë të Londrës dhe të Versajit) kishte mbetur nën Jugosllavinë. Thuhej se "është shumë e mundur që Jugosllavia pas lufte ta kërkojë jo vetëm kthimin e Kosovës dhe pjesës tjetër shqiptare, por si shtesë të kësaj edhe Shkodrën si dhe Luginën e Drinit".

Ndërsa, në lidhje me Greqinë, thuhej se pretendimet territoriale të saj ndaj Shqipërisë ishin më vokale se sa ato të jugosllavëve. Bëhej e ditur se në Greqi ekziston një numër i konsiderueshëm i banorëve me prejardhje shqiptare.

(Vijon)

Sveçla takon ambasadorin Hovenier, ShBA-ja aleate kyçe e Kosovës

PRISHTINË, 29 MARS (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka zhvilluar një takim me ambasadorin e Shteteve të

Bashkuara të Amerikës, Jeff Hovenier, me të cilin ka folur për angazhimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe për synimet dhe prioritetet pas

njëvjeçarit të punës. Sipas njoftimit të MPB-së, ministri Sveçla ka falënderuar ambasadorin për mbështetjen e vazhdueshme

të ShBA-së si aleat kyç i Republikës së Kosovës dhe është rikonfirmuar mbështetja për arritjen e objektivave që ka kjo ministri.



Këshilli Drejtues i PDK-së i hap rrugë themelimit të Kabinetit të Qeverisjes së Mirë

Në mbledhjen e Këshillit Drejtues të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) është bërë me dije se Kabineti i Qeverisjes së Mirë do të përbëhet nga ekspertë me kredibilitet të fushave të ndryshme që do të jenë nga kryesia, grupi parlamentar dhe ekspertë jashtë PDK-së të cilët do ta japin alternativën e ardhshme qeverisëse që do ta udhëheqë PDK-ja

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 MARS - Anëtarët e Këshillit Drejtues të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) i kanë dhënë dritën jeshile nisjes së themelimit të Kabinetit të Qeverisjes së Mirë. Me unanimitet, Këshilli Drejtues i PDK-së ka miratuar rregulloren për funksionimin e Kabinetit të Qeverisjes së Mirë që, sipas statutit të PDK-së, është parakusht për themelimin e KQM-së.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se në këtë

mbledhje PDK-ja, siç ka qenë alternativë për qytetarët në zgjedhjet lokale, ngjashëm do të bëhet alternativë për qytetarët dhe për Kosovën në nivelin qendror. "Këto zgjedhje na kanë mësuar atë që e dinim e duhet ta mbajmë mend gjithmonë, se qytetari i Kosovës po ndryshon dhe se PDK-ja është në hap me ndryshimet për të cilat qytetari ka nevojë. Na kanë konfirmuar se fjalët, dramatizimet dhe ligjërimet kurrë s'kanë qenë e kurrë s'do të jenë zëvendësim për afërsinë, ndjeshmërinë dhe trajtimin e përbashkët të temave konkrete me rëndësi

për qytetarët e Kosovës. Dhe pa asnjë dyshim na kanë motivuar, për ta kapur këtë moment, e për ta përhapur këtë frymë jo më vetëm në transformimin e jetës së qytetarëve nëpër komuna, por edhe në nivelin qendror, sepse ky moment nuk është moment veç për PDK-në. Është, para së gjithash, moment për qytetarin që ka nevojë sot më shumë se kurrë për një Parti Demokratike të fortë e unike, në të cilën ai mund të besojë në planet e perspektivës dhe të ardhmes së tij. Prandaj, ky moment nuk mund të ikë. Dhe si kryetar i PDK-së ju garantoj sot se nuk do ta lëmë të ikë", ka thënë Krasniqi.

Kreu i PDK-së ka theksuar se është konsoliduar një agjendë e mirëfilltë parlamentare si opozitë, duke nxjerrë në Kuvend shumë debate e deficite të qeverisë aktuale dhe do ta vazhdojë betejën për qytetarët përballë një qeverie të

paaftë. "Kjo jo vetëm që është detyrë e jona si opozitë, por është edhe detyrë ndaj qytetarëve sepse sfidat me të cilat po përballen qytetarët kërkojnë angazhim edhe më të madh nga ana jonë. Jo veç për të fol e ekspozuar problemet, por edhe për të ofruar alternativë për to. Jam shumë i bindur se qytetarët e Kosovës sot e kanë shumë të qartë se pse i duhet Kosovës PDK-ja", ka deklaruar Krasniqi.

Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, gjatë paraqitjes së rregullores së Kabinetit të Qeverisjes së Mirë, ka pohuar se KQM-ja do të përbëhet nga gra e burra ekspertë me kredibilitet të fushave të ndryshme që do të jenë nga kryesia, grupi parlamentar dhe ekspertë jashtë PDK-së të cilët do ta japin alternativën e ardhshme qeverisëse që do ta udhëheqë PDK-ja.

Në mbledhjen e Këshillit Drejtues u diskutua edhe për

rezultatet e Partisë Demokratike në zgjedhjet e fundit lokale ku PDK-ja ka fituar shumicën e komunave të mëdha të Kosovës, ndërsa u vendos për riorganizim të degëve të PDK-së që kanë shënuar rezultate të dobëta në zgjedhjet e fundit.

Anëtarët e Këshillit Drejtues të PDK-së kanë vlerësuar faktin që në tri vitet e fundit PDK-ja ka qenë partia e vetme që raportet e Auditorit të Jashtëm i ka pasur të pakualifikuara, duke evidentuar menaxhim financiar efikas dhe transparent. Dhe për të vazhduar këtë qasje transparente të menaxhimit të financave, Këshilli Drejtues ka miratuar Rregulloren për Menaxhim të Financave.

Po ashtu, anëtarët e Këshillit Drejtues diskutuan dhe e vlerësuan lart nisjen e riorganizimit politik të PDK-së në mërgatë si dhe diskutuan për anëtarësimin e PDK-së në organizata ndërkombëtare simotra.



Konjufca: Kosova dhe Shqipëria përballë sfidave duhet të jenë afër njëra-tjetrës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim një delegacion të Komisionit për Politikën e Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të kryesuar nga Mimi Kodheli, kryetare e komisionit.

Në takim u diskutua për bashkëpunimin e ngushtë që Kosova dhe Shqipëria kanë ndërtuar në shumë fusha, veçanërisht në rrafshin parlamentar, gjithashtu u shtrua nevoja e shfrytëzimit të hapësirave për t'i thelluar më tej këto marrëdhënie.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se vizitat e ndërsjella të delegacioneve të ndryshme të parlamenteve respektive kontribuojnë në këmbimin e përvojave dhe avancojnë më tej bashkëpunimin ndërparlamentar. "Vendet dhe parlamentet tona janë vëllazërore, andaj përballë sfidave rajonale dhe globale duhet të jemi sa më afër njëri-tjetrit. Këto vizita dëshmojnë shtimin e marrëdhënive dhe të bashkëpunimit ndërparlamentar", ka theksuar Konjufca.

Kreu i Kuvendit ka falënderuar Kodhelin për afirmimin e kërkesave të Kosovës nga ana e Shqipërisë brenda strukturave të NATO-s.



Duke shprehur kënaqësinë që gjendet për vizitë në Kosovë dhe në kuvendin e saj, kryetarja e

delegacionit nga Kuvendi i Shqipërisë, Mimi Kodheli, ka vlerësuar lart frytet e

bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, ndërsa ka konfirmuar mbështetjen e vazhdueshme të Tiranës zyrtare për Kosovën në të gjitha sferat. Ajo ka thënë se Kosova dhe Shqipëria janë pjesë të të njëjtit komb dhe se është kënaqësi e veçantë vizita në Prishtinë.

Kodheli ka folur edhe për takimet e qeverive të të dyja vendeve dhe për marrëveshjet e arritura për të cilat ka thënë se kanë nevojë për mbështetjen e parlamenteve. Gjatë takimit janë shkëmbyer informacione dhe ide për zhvillimet politike e ekonomike në Shqipëri e Kosovë, si dhe janë shqyrtuar mundësitë e përafritimit të mëtejshëm të të dyja vendeve në të gjitha fushat.

Themelimi i grupeve për mbikëqyrje, cenim i pavarësisë së BQK-së



**Shkruan: Safet
GËRXHALIU**

Pavarësia e Bankës Qendrore i referohet lirisë së saj nga ndikimi i drejtpërdrejtë politik ose qeveritar. Gjatë viteve 1970 dhe fillim të viteve 1980, ekonomitë kryesore të industrializuara të botës përjetuan periudha me inflacion të lartë. Pas këtyre periudha shumë analistë më të njohur të kohëve tentuan të analizojnë se pse bankat qendrore i lejuan ato të ndodhnin? Në bazë të krahasimeve krahasimtare të vendeve të ndryshme, shumë hulumtues kanë vënë në dukje se presionet politike ishin arsyt kryesore të inflacionit në këto vende. Politikanët e zgjedhur shpesh mund të motivohen nga konsideratat elektorale afatshkurtra, ose mund të vlerësojnë shumë rritjet ekonomike afatshkurtra, ndërkohë që në planin afatgjatë si pasojë e këtyre politikave vijnë pasojat afatgjata inflacioniste dhe luhatja së stabilitetit financiar në vend. Tendencat e politikanëve të zgjedhur për t'i shtrembëruar politikat ekonomike mund të rezultojnë shumë të dëmshme për ekonominë e

vendit. Për këtë arsye pavarësia e Bankës Qendrore në vend është e rëndësishë jetike për funksionimin e ekonomisë dhe financave në vend. Për ta siguruar stabilitetin financiar në një vend, bankat qendrore bashkëkohore janë të ndara nga qeveria dhe Ministria e Financave e vendit.

Filluar nga vitit 2020, kur pandemia e shkaktuar nga Covid-19 bëri që e gjithë bota ta përjetojë krizën më të thellë ndonjëherë dhe ende pa dalë nga kjo krizë me pasoja të tmerrshme për njerëzit dhe ekonomitë në gjithë globin, lufta në Ukrainë vetëm sa ka bërë që gjendja nga shumë e keqe të kalojë në gjendje të tmerrshme, ku stabiliteti financiar dhe ekonomik edhe në vendet më të zhvilluara janë bërë sfida shumë e komplikuar, inflacioni gati dyshifror ka shtyrë në shqyrtim skenarët më të këqij të stres testeve të këtyre vendeve.

Në Kosovë në drejtim krejt të kundërt të zhvillimeve në vendet demokratike, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere i Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e së mërkurës si pikë të të rendit ditës ka paraparë edhe formimin e grupit punues lidhur me 'mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës'.

Ky paralajmërim për themelimin e këtij grupi do të jetë goditje e rëndë për stabilitetin financiar në vend dhe paraqet shkelje të rëndë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për BQK-në, e cila

e ka të garantuar pavarësinë e saj, ku neni 140 thotë se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është institucion i pavarur i cili i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës dhe se qeverisja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe procedurat e zgjedhjes dhe të nominimit të anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës rregullohen me ligjin, i cili duhet ta sigurojë pavarësinë dhe autonominë e saj.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës sot është institucioni më kredibil dhe më i besueshëm në vend. Këtë vlerësim e kanë dhënë edhe organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të cilat kanë dhënë nota të larta për institucionin rregullues financiar në vend. Pra, është e rrugës që Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere i Kuvendit të Kosovës fare të mos tentojë dhe të krijojë grupe punuese të cilat do ta prekin pavarësinë e BQK-së.

Tendencat për ta kapur BQK-në dhe për të ndërhyrë në proceset e saj cenon proceset të rëndësishme, komplekse, që kanë ndjeshmëri për Kosovën, siç është edhe procesi i Arbitrazhit Ndërkombëtar të Lute Credit kundër Republikës së Kosovës. Në vitin 2020, kur bota u përfshi nga pandemia Covid-19 dhe shumë shtete dhe institucione financiare ndërkombëtare u ballafaquan me probleme, ishte BQK-ja që në Kosovë përmes vendimeve të saj arriti ta ruajë besimin dhe qytetarët e Kosovës të jenë të sigurt me mjetet e tyre

që i kanë në institucionet bankare në vend.

Pra pavarësia e BQK-së është cruciale për të ecur tutje dhe të jetë në harmoni edhe me politikatat e aktorëve financiarë në vend. Po ashtu, një problem që shumë shtete e kanë, përfshirë edhe vendet e rajonit, është problemi i kredive të këqija të cilat në vende e tjera kanë përqindje shumë më të lartë se Kosova. Pra edhe pse pandemi, falë BQK-së, ne kemi arritur të kemi shumë pak kredi joperformuese, të kemi kapitalizim të lartë të likuiditetit në shumë sektorë, po ashtu është rritur edhe konkurrenca dhe kemi institucione të reja në Kosovë që shtrijnë aktivitetin bankar në vend.

Nuk duhet harruar që me pavarësinë që sot ka BQK-ja janë bërë hapa shumë pozitivë. Edhe ideja që të kemi liberalizim të tregut të sigurimeve TPL është jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë.

Nëse do të kemi lëvizje nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere i Kuvendit të Kosovës, dhe do të themelohen grupe për mbikëqyrje të BQK-së, është e sigurt se do të prishet imazhi pozitiv i Kosovës sa iu përket aktiviteteve të sistemi bankar e financiar në vend dhe ndërhyrje në institucionet e pavarura në Kosovë.

Sot në Kosovë janë disa banka vendore e ndërkombëtare të cilat së bashku e përbëjnë mozaikun e sistemit bankar në vend. Bankat e huaja e kanë model Kosovën për funksion të mirë të sistemit

bankar, zhvillim të mirë të sistemit të pagesave dhe kjo është arritur falë përkushtimit të pavarësisë së funksionimit të BQK-së.

Sot bota kapitaliste u beson institucioneve të pavarura dhe të drejtësisë dhe nuk do të ishte mirë që të ketë ndërhyrje politike dhe tendenca për ta pasur nën kontroll BQK-në. Këto tendenca do të mund të ndikojnë edhe në procese të ndryshme që lidhen me Kosovën në arenën ndërkombëtare.

Të gjitha raportet ndërkombëtare BQK-në e kanë vlerësuar lart. Njëri ndër to është edhe Komisioni Evropian ku BQK-në e ka vlerësuar me notën 3, kurse vendin në total e ka vlerësuar me 1.9. Edhe Departamenti i Shtetit ka dhënë vlerësime pozitive për BQK-në, pastaj Banka Botërore, FMN-ja dhe institucione të tjera ndërkombëtare.

Nuk është faji i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, se pse nuk është votuar me kohë bordi i BQK-së nga Kuvendi i Kosovës, pra vonesa e bordit ka shkaktuar vonesa në funksionalizimin e tërësishëm të BQK-së. Për fund edhe agresioni rus në Ukrainë ka prekur sistemin financiar në gjithë botën për shkak të tregjeve globale ku bën pjesë edhe Kosova, edhe pse si vend i vogël. Me besimin dhe vlerësimin që ka BQK-ja është arritur të ruhet besueshmëria qytetare ndaj sistemit bankar dhe financiar në vend. Pra rol kyç në këtë segment ka BQK-ja që përmes politikave ka arritur ta ruajë imazhin pozitiv të Kosovës.

Osmani takon komunitetin e biznesit në Katar

PRISHTINË, 29 MARS (ER) - Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani, gjatë vizitës në Katar, ka takuar edhe udhëheqësit e Odës Ekonomike të Katarit dhe udhëheqësen e Fondacionit të Katarit si dhe i është drejtuar audiencës së Qendrës Arabe për Hulumtime dhe Studime Politike.

Në takim me kryetarin e Odës Ekonomike të Katarit, Khalifa bin Jassim Al Thani dhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit në Katar, presidentja ka diskutuar për mundësitë e rritjes së investimeve në fusha të ndryshme, duke përfshirë bujqësinë, turizmin dhe infrastrukturën.

Presidentja Osmani, gjithashtu, është prititur nga kryeshefja ekzekutive e Fondacionit të

Katarit, Sheikha Hind Bint Hamad Al Thani, ku është diskutuar për avancimin e arsimit dhe sistemit shëndetësor si parakusht për zhvillimin e kapitalit njerëzor.

Presidentja Osmani ka bashkëbiseduar edhe me një grup studiuesish në një ligjëratë të organizuar nga Qendra Arabe për Hulumtime dhe Studime Politike, ku ka diskutuar për historinë e Kosovës, impaktin e luftës, procesin e shtetndërtimit dhe pozitën aktuale të Kosovës në politikën botërore.

Në bashkëbisedim me pjesëmarrësit, presidentja ka folur mbi agresionin rus në Ukrainë dhe politikat destabilizuese të presidentit rus dhe satelitëve të tij në rajonin e Ballkanit.



Mbi 400 milionë kopje të shitura, çfarë e bën ende kaq të suksesshëm Leon Tolstoin?



Sa herë që mendoni mbi veprat e mëdha të letërsisë ruse, ka shumë mundësi që mendja t'iu shkojë menjëherë tek shkrimtari Leon Tolstoi. Romanet e tij "Lufta dhe Paqja" dhe "Ana Karenina" i mahnitën lexuesit kur u botuan për herë të parë, dhe më shumë se një shekull më vonë, konsiderohen ende si ndër veprat më të mira letrare të shkruara ndonjëherë. Por shitjet e librave janë vetëm një pjesë e historisë. Ja çfarë duhet të dini më shumë për jetën dhe karrierën e Leon Tolstoit.

Nuk e donte romanin "Lufta dhe Paqja"

Shkrimi i kësaj vepre voluminoze, ishte një proces rraskapitës për Tolstoin. Ai e rishikoi vazhdimisht veprën, dhe vetëm për pjesën e parë realizoi 15 draftet dhe shpenzoi gati 1 vit për ta shkruar siç duhet. Por në fund, u shpërblye e gjithë puna e tij e palodhur.

"Lufta dhe Paqja" është padyshim vepra e tij më e famshme, dhe një nga romanet më të famshëm që është shkruar ndonjëherë. Por pavarësisht se shpenzoi kaq shumë kohë me të (ose ndoshta për shkak të këtij fakti), Tolstoi u bë përçmues ndaj romanit.

Në një letër drejtuar një miku të tij, ai shprehej se historia ishte e

zmadhuar më shumë seçduhej. Ndërkohë në ditarin e tij, shkroi: "Njerëzit më duan për vogëlsirat që kam shkruar – si Lufta dhe Paqja e kështu me radhë – të cilat ata mendojnë se janë kaq shumë të rëndësishme".

Romani "Ana Karenina", u frymëzua nga një ngjarje reale

Ngjarjet e Ana Kareninës mund të jenë bazuar tek një dramë e jetës reale, që preku mikun dhe njëherazi fqinjin e Leo Tolstoit, Aleksandër Nikolajevič Bibikov, që kishte një lidhje romantike me një grua të quajtur Ana Stepanovna Pirogova. Por Bibikov filloi që ta linte atë pas dore, në favor të dados gjermane të fëmijëve të tij. E pushtuar nga xhelozia, Stepanovna iku në fshat, ku u end e pikëlluar për disa ditë, përpara se t'i dilte para një treni duke vrrarë veten. Tolstoi ishte dëshmitar në autopsinë e saj, dhe ajo ngjarje e preku aq sa një vit më vonë, vendosi ta kthejë atë në një roman.

Bashkëshortja e tij, Sofia, ishte një aset i paçmuar për karrierën e tij

Shumë artistë të mëdhenj, kanë përfituar nga puna e padukshme e partnerëve të tyre. Por mbështetja që mori Leon Tolstoi nga gruaja e tij,

ishte më se e dukshme. Sofia ulej përkrah tij gjatë kohës që ai shkruante, dhe i jepte shpesh sugjerime, apo ia redaktonte tekstin. Ishte ajo që ri-shkroi të gjitha draftet e tij, në mënyrë që ai të kishte një dorëshkrim të lexueshëm kur t'ua dërgonte botuesve, gjë që duhet të ketë qenë mjaft sfiduese duke pasur parasysh numrin e lartë të faqeve të dorëshkrimeve të Tolstoit. Nga ana e biznesit, Sofia ishte ajo që e nxitte atë të botonte "Lufta dhe Paqja" si një roman të plotë, në vend të tregimeve nëseri.

Leon Tolstoi dhe Sofia patën 13 fëmijë

Me gruan e tij, Sofia, Leon Tolstoi pati 13 fëmijë, 8 nga të cilët mbijetuan deri në moshë madhore. Disa ndoqën shembullin e babait të tyre duke u bërë shkrimtarë, përfshirë Ilija Tolstoi dhe Lev Tolstoi. Sot janë gjallë qindra nga pasardhësit e tij të drejtpërdrejtë, ndërsa 2 herë në vit ata organizojnë mbledhjet familjare të Tolstoit në vilën e tij (sot një muze) në Jasnaja Poliana, Rusi.

Është një nga shkrimtarët më të shitur të të gjitha kohërave

Është e vështirë të thuhet një shifër e saktë e kopjeve të shitura të librave të botuar para

shekullit XX-të. Por është e sigurt të thuhet se librat e Tolstoit janë best-seller të përhershëm. Vetëm në vitin 2004, "Ana Karenina" rifitoi interesin e lexuesit falë një promovimi nga "Klubi i Librit" të moderatores së njohur amerikane Opra Uinfri, dhe botuesi e rriti atë vit tirazhin nga 20.000 në 800.000 kopje. Romani "Lufta dhe Paqja", shiti kopje të mjaftueshme për t'u përfshirë në listën e 50 librave më të mirëve të shitur ndonjëherë në Britaninë e Madhe. Sipas disa vlerësimeve, deri më sot janë shitur më shumë se 400 milionë kopje të veprave të Tolstoit.

Nuk e fitoi kurrë Çmimin Nobel

Kur Çmimi Nobel për Letërsi nisi të jepej për erë të parë në vitin 1901, shumë njerëz supozuan se fituesi do të ishte Leon Tolstoi. Në atë që cilësohet ende si një nga mospërfilljet më të mëdha në historinë e këtij çmimit, Nobeli iu dha atë vit poetit francez Salli Prydom. Dyzet e dy shkrimtarë dhe artistë suedezë i shkruan Tolstoit për t'i shprehur kundërshtimin e tyre ndaj vendimit të komitetit të Nobelit. Por shkrimtari rus iu përgjigj: "U lumturova kur mësova që nuk

m'u dha Çmimi Nobel. Më privoi nga problemi i madh se si do t'i shpenzoja paratë". Ai u nominua si kandidat deri në vitin 1906.

Thënie të paharrueshme të Leon Tolstoit:

"Në rast se nuk do të kishte mjete të jashtme për zbehje e ndërgjegjes së tyre, gjysma e njerëzve do të vrisnin veten menjëherë, pasi të jetosh në kundërshtim me arsyen është një gjendje shumë e patolerueshme, dhe të gjithë njerëzit e kohës sonë ndodhen në një gjendje të tillë."

"Besimi është domethënia e kësaj jete, ai kuptim me anë të të cilit njeriu nuk e shkatërron veten, por vazhdon të jetojë. Është forca përmes së cilës jetojmë."

"Ndryshimet në jetën tonë, duhet të vijnë nga pamundësia për të jetuar ndryshe, dhe jo sipas kërkesave të ndërgjegjes sonë, dhe as nga vendosmëria jonë mendore për të provuar një formë të re të jetës."

"Gjatë gjithë historisë nuk ka pasur asnjë luftë që nuk është nxitur nga qeveritë, në mënyrë të pavarur nga interesat e njerëzve, për të cilët lufta është gjithmonë e dëmshme edhe kur është e suksesshme".

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Kosova ndahet miqësisht me Zvicrën

Kosova ka barazuar në Cyrih në përballje me Zvicrën (1-1), e cila llogaritet si një fuqi në futbollin evropian. Për “dardanët” shënues ishte Milot Rashica, derisa për zviceranët Jordan Lotomba. Siç dihet Kosova në këtë muaji arriti edhe një rezultat pozitiv, duke mposhtur Burkina Fasos (5-0)

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka regjistruar edhe një rezultat pozitiv në ndeshjen miqësore ndaj Zvicrës, pasi barazoi në Cyrih me rezultat 1-1. Pas fitores ndaj Burkina Fasos (5-0), “dardanët” morën barazim në ndeshjen e dytë nën drejtimin e Alain Giresse. “Jam shumë i lumtur me ekipin, me paraqitjen e bërë. Është matematikë. Janë dy lojë dhe tre portierë. E kam ditë që stadiumi do të jetë komplet, që ka shumë tifozë të Kosovës dhe na është dukur si të luajmë në Prishtinë. Dy ndeshjet që kemi luajtur kanë qenë pozitive. Angazhimi dhe motivimi i lojtarëve ka qenë i mirë”, ka thënë pas ndeshjes Alain Giresse, trajneri i Kosovës. Ndeshja në Cyrih ishte një

festë futbollit, pasi në shkallët e stadiumit ishin mbi 20 mijë tifozë, ku shumica prej tyre shqiptarë që jetojnë e veprojnë në shtetin zviceran. Kosova rastin e parë serioz e pati në minutën e 32-të, kur Valon Berisha godet me kokë por topi ndalet nga portieri vendas. Në anën tjetër zviceranët rrezikuan dy herë portën me Zuber dhe Shaqirin, por Aro Muriçi nuk lejoi të mposhtet. Kosova e nisi shkëlqyeshëm pjesën e dytë, duke kaluar në epërsi me golin e Milot Rashicës, në minutën e 52-të. Zviceranët barazuan rezultatit vetëm nëntë minuta më vonë me golin e Jordan Lotombas, i cili përfitoi nga një dalje e gabuar e portierit Muriçi. Me rezultat 1-1 përfundoi ndeshja. “E veçante për mu, për familjen, për miqtë. Një lojë kundër vendlindjes time, një vend që e dua shumë. Kosova



ka luajtur mirë, edhe ne kemi luajtur mirë. E kam një karakter që dua te jem në fushë. Dua të luaj sa më shumë për Zvicrën. Kjo temë po bëhet pak më e madhe, kështu që nuk dua të zgjasë këtë temë. Një ekip shumë i mirë, me lojtar individual të mirë. Besoj se në të ardhmen do të kenë sukses”, ka deklaruar kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka. Ndeshjet e ardhshme të Kosovës janë në qershor, në kuadër të Ligës së Kombeve.

Shqipëria ndahet baras me Gjeorgjinë

Shqipëria bëri më shumë, por në fund u desh të pajtohej me një barazim 0-0 në miqësore kundër Gjeorgjisë së drejtuar nga francezi Willy Sagnol. Shqipëria ishte më këmbëngulëse në pjesën e parë dhe iu afrua golit të avantazhit me anë të mesfushorit Endri Çekiçi, i cili nga brenda zonës e çoi topin mbi traun e portës. Miqtë nga Gjeorgjia rrezikuan menjëherë me anë të

Davitashvili. Ai kishte një rast të artë, por goditi keq. Asnjë gol në 45 minutat e para, ndërsa në të dytën Cikalleshi dhe Vrioni iu afruan shumë golit. Kvekveskiri për miqtë provoi nga distanca, por Strakosha ishte në gatishtëri dhe e ndali. Për Shqipërinë u mundua ta zgjidhte Asllani, i cili gjuajti fort nga jashtë zone dhe vuri në vështirësi portierin mik. Kuqezinjët u munduan të shënojnë deri në fund, por Gjeorgjia rezistoi dhe gjithçka përfundoi në barazim 0-0.

41 sportistë do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Mesdhetare

PRISHTINË, 29 MARS - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës, nën drejtimin e presidentit Ismet Krasniqi, ka mbajtur të martën mbledhjen e 10 në të cilën janë shqyrtuar pika të ndryshme të rendit të ditës. Ndër të tjera është aprovuar numri prej 41 sportistëve nga 14 sporte të ndryshme të cilët do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Mesdhetare “Oran 2022”. Këto lojëra mbahen prej 25 qershorit deri më 5 korrik 2022. Propozimi ishte bërë nga



komisioni i sportit. “U aprovua numri prej 41 sportistëve nga 14 sporte të ndryshme, të cilët do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Mesdhetare Oran 2022. LM Oran 2022 mbahet prej 25 qershorit deri më 5 korrik 2022. Propozimi ishte bërë nga komisioni i sportit”, thuhet në njoftimin e KOK-ut. Në këtë mbledhje, gjithashtu, u aprovua raporti i komisionit të sportit për numrin prej 13 sportistësh nga shtatë federata sportive, të cilët do ta përfaqësojnë Kosovën në

Festivalin Olimpik Evropian Veror për të Rinj, që prej 24 deri më 30 korrik 2022, mbahet në Banska Bistrica të Sllovakisë. Gjithashtu u vendos që të dërgohet rekomandimi për mbështetje të përhershme financiare nga MKRS-ja për trajnerët e bodybuildingut, Esat Lata dhe Sabri Dragusha, për medaljet e fituara nga sportistët Kushtrim Bajraktaraj dhe Granit Kuleta në Kampionatin Botëror, respektivisht Kampionatin Evropian.

Gjysmëfinale interesante te femrat

PRISHTINË, 29 MARS - Të mërkurën do të zhvillohen ndeshjet e para gjysmëfinale në “play-off” të Superligës së Femrave. Skuadra që shënon dy fitore do të kualifikohet në finale. Në gjysmëfinalen e parë do të përballen Prishtina me Trepçën. Prishtinaset përfunduan garat e rregullta me 20 fitore në 20 ndeshje, duke mos pësuar asnjë humbje, kurse mitrovicaset kishin

tetë fitore e 12 fitore. Në takimet mes tyre në këtë edicion katër fitore shënuan vashat prishtinase, që janë favorite për të depërtuar në finale. Në gjysmëfinalen e dytë do të takohen Penza dhe Bashkimi. Kampionet përfunduan garat e rregullta me 15 fitore e pesë humbje, ndërsa fitueset e Kupës me 12 fitore e tetë humbje. Vashat pejana duan të depërtojnë në finale

dhe ta mbrojnë titullin, kurse ato prizrenase, pasi fituan Kupën e Kosovës duan edhe një trofe për këtë edicion. Në përballjet e këtij edicioni skuadra pejana ka mundur tri herë atë prizrenase në elitën e femrave, kurse skuadra prizrenase i ka mundur në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës. Në Ligën Unike u përballën dy herë dhe dy herë triumfoi Penza.



GJYSMËFINALET

Të mërkurën takohen:
 16:00 Prishtina - Trepça
 19:00 Penza - Bashkimi

Karateisti Herolind Nishevci i jep fund karrierës

PRISHTINË, 29 MARS - Karateisti Herolind Nishevci ka vendosur t'i japë fund karrierës. Nishevci bëri me dije se tashmë i ka dhënë fund karrierës si garues i Kosovës, por edhe Shqipërisë. Ai ka shtuar se do të jetë

gjithmonë mirënjohës ndaj familjes dhe gjithë të tjerëve që e ndihmuan gjatë rrugëtimit të tij drejt medaljeve. "Përmbyllja zyrtare e karrierës si garues i reprezentacionit të Kosovës dhe të Shqipërisë. Mirënjohës

si gjithmonë ndaj familjes sime dhe të gjithë të tjerëve, të cilët më ndihmuan dhe më përcollën gjatë rrugëtimit tim drejt medaljeve ballkanike, evropiane, botërore", ka thënë Nishevci.

30-vjeçari gjatë karrierës së tij fitoi medaljen e bronzit në Kampionatin Botëror 2016 dhe në Evropianin 2021. Herolind Nishevci, gjithashtu, u shpall dy herë sportisti i vitit në Kosovë, më 2016 dhe 2017.



Përballje interesante në çerekfinale të Ligës Unike

PRISHTINË, 29 MARS - Të mërkurën do të zhvillohen ndeshjet e para çerekfinale të "play-off"-it të Ligës Unike në konkurrencën e meshkujve. Skuadra që është më e mirë në dy ndeshje do të kualifikohet në gjysmëfinale, ku tashmë janë kualifikuar Golden Eagle Ylli nga vendi i parë dhe Peja nga vendi i dytë. Në çerekfinale e parë do të përballen Rahoveci dhe Prizreni 16. Vreshtarët përfunduan garat e rregullta me shtatë fitore e shtatë humbje, kurse prizrenasit me tetë fitore e gjashtë humbje. Në takimet mes tyre në këtë edicion të Ligës Unike, dy skuadrat kanë nga një fitore ndaj njëra-tjetrës, andaj



priten dy sfida shumë interesante në çerekfinale të kësaj gare. Në çerekfinale e dytë do të përballen dy skuadrat shqiptare, Tirana Neptun dhe Teuta e Durrësit. Të dyja skuadrat kishin nga shtatë fitore e shtatë humbje në garat e

rregullta, duke përfunduar në pozitën e dytë, përkatësisht të tretë. Në dy takimet mes tyre në këtë edicion të Ligës Unike fitore ka shënuar skuadra tiranase, megjithatë priten dy takime me mjaft rivalitet.

ÇEREKFINALET

Të mërkurën takohen:

19:00 Rahoveci - Prizreni 16
19:00 Teuta - Tirana

Miami rikthehet lider në Lindje, humbasin Golden State dhe Bostoni

MIAMI, 29 MARS - Pas katër humbjesh radhazi, rikthehet te fitorja skuadra e Miamit, e cila e mposhti me rezultat 123-100 Sacramenton dhe në këtë mënyrë ngjitet në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes. Ndeshje e komanduar nga Miami, ku katër lojtarë realizuan mbi 20 pikë (Butler 27 pikë më i miri). Vetëm 24 orë ka kryesuar renditjen në Lindje skuadra e Bostonit, që sot



u mund me shifrat 115-112 nga Toronto pas kohës shtesë. Sfidë e ekuilibruar deri në fund, ku për kanadezët shkëlqeu Siakam me 40 pikë e 13 rebounde (Smart 28 pikë për Bostonin). Humbet sërish ekipi i Golden States, që u mund me rezultat 123-95 nga

Memphis (Bane 22 pikë), ndërsa San Antonio, falë 33 pikëve e 11 asistimeve të Murrayt, fitoi me rezultat 123-120 ndaj Houstonit. Denveri, falë një "triple double" të Nikola Jokiqit (26 pikë, 19 rebounde, 11 asistime), mundi me rezultat 113-109 Charlotten.

REZULTATET

| | |
|------------------------|---------|
| Charlotte - Denver | 109-113 |
| Cleveland - Orlando | 107-101 |
| Indiana - Atlanta | 123-132 |
| Miami - Sacramento | 123-100 |
| New York - Chicago | 109-104 |
| Toronto - Boston | 115-112 |
| Houston - San Antonio | 120-123 |
| Memphis - Golden State | 123-95 |
| Portland - Oklahoma | 131-134 |

SHKURT

Të enjten shorti për gjysmëfinale të Kupës së Kosovës

Komisioni i Garave ka vendosur që shorti për gjysmëfinale të Kupës së Kosovës të mbahet të enjten (më 31 mars). Tërheqja e shortit bëhet në selinë e FFK-së në orën 13:00. Në këtë rreth të garave marrin pjesë katër skuadra: Drita, Prishtina, Llapi dhe Ramiz Sadiku. Padyshim se priten të zhvillohen ndeshje interesante në gjysmëfinale. Ramiz Sadiku është skuadra e vetme nga Liga e Parë që ka arritur deri në këtë rreth të garave.

Enriques nuk i intereson oferta e Unitedit

Përzgjedhësi i Spanjës, Luis Enrique, e ka përjashtuar veten nga gara për postin e trajnerit të Manchester Unitedit duke e bërë të qartë se do të jetë në Kampionatin Botëror në Katar. Për herë të parë në histori Kampionati Botëror do të mbahet dimrit, ndërsa La Roja është në mesin e favoritëve në turneun e ardhshëm. "Në Katar do të jem me Spanjën dhe çfarë do të vijë më pas, do të shohim. Si mund të ketë ende dyshime? A duhet ta përsëris më shumë herë? Nuk ka asnjë pozitë që më emocionin më shumë sesa ta përfaqësoj vendin tim në Katar", ka thënë Enrique.

Dortmundi shfaq interesim për Wernerin

Timo Werner mund të largohet nga Chelsea në afatin kalimtar të kësaj vere. Sulmuesi gjerman që kur kaloi te blutë nga RB Leipzig nuk ka arritur ta gjejë vetën në sistemin e lojës së tyre. "90min" raporton se sulmuesi është bërë cak i Borussia Dortmundit. Në listën e klubit nga Bundesliga është edhe Anthony Martial i Manchester Unitedit, që aktualisht është në huazim te Sevilla. Por, Dortmundi do të synojë që më parë ta ofrojë Wernerin, duke ditur se te rivali i tyre në ligë ishte një sulmues vrtastar.

Vdes në moshën 28-vjeçare portieri Van Dam

Club Brugge, skuadra e Kategorisë së Parë belge, ka njoftuar mëngjesin e sotëm një lajm të hidhur. Portieri i saj Miguel Van Dam, 28 vjeçar, humbi betejën me leukeminë pas pesë vjetësh luftime, njoftojnë mediet e huaja. Miguel Van Dam e filloi karrierën e tij si sulmues në Lembeke, për t'u ricaktuar në pozicionin e portierit. Kur ai mbushi 17 vjeç, erdhi një ofertë nga Club Brugge, të cilën ai e pranoi me kënaqësi. Vdekja e hershme e futbollistit të ndjerë e ka tronditur gjithë Belgjikën.

Laporta zhgënjën tifozët e Barçës: Messi nuk rikthehet

Lionel Messi verën e kaluar iu bashkua PSG-së, por duhet se ai nuk është i lumtur në klubin francez dhe kohët e fundit është folur për rikthim në Barcelonë. Një gjë të tillë e ka

përjashtuar presidenti Joan Laporta, i cili mbyll dyert për rikthimin e Messit. "Nuk kam marrë asnjë mesazh nga Leo apo rrethi i tij në këtë drejtim. Për momentin nuk po

mendojmë për rikthimin e tij. Ne po ndërtojmë një ekip të ri. Leo është lojtari më i mirë në botë, por ne nuk po mendojmë për rikthimin e tij. Nuk do të donim të bënim një

hap prapa. Barça është shtëpia e Leos. Do të doja që ai të ishte i pranishëm në hapjen e 'Camp Nou'-së të ri. Marrëdhënia jonë është ndryshe tani. Ai është në Paris.

Nuk ishte e lehtë për mua. Do të kisha pëlqyer që gjërat të ishin ndryshe. Vuri klubin në rrezik. Mendoj se bëme atë që duhej të bënim. Nuk flas me të si më parë", ka thënë Laporta.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:

044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Violete Rakaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes" Vermice.
- ▶ Vlera Pepniku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.
- ▶ Shani Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Heronjtë e Kabashit " Korishe.
- ▶ Aida Hajdari shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Harun Beka".
- ▶ Besnik Hajrizi shpalle te pavlefshme dëftesën certifikatën dhe diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- ▶ Jeton Sejdu shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLM " Dr. Xheladin Deda".
- ▶ "Buli Plast" ShPK shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810068701.
- ▶ Vera Mulaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Q.A.M.O-SH "Hysni Zajmi" infermiere teknike drejtimi Pediatri.
- ▶ Visar Sylmetaj Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "7 Shtatori" Gerqinë nga kl. I-VIII.
- ▶ Flamur Hoti nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U. Haxhi Hoti nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Valtrim Sylmetaj Graina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U. "7 Shtatori" nga kl I-V dhe VI-IX.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 307/2022 të datës 15 Shkurt 2022, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS

I. Referent i Lartë

Prokuroria Themelore Prishtinë, një (1) pozitë

Referenca: KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 003
Emri Pozitës: Referent i Lartë
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Kodi punës: DR/850
Raporton tek: Udhëheqës i Shkrimore
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë
Koeficienti: Shtatë (7)
Akti i emërimit: Pa afat
Periudha provuese: Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike lidhur me lëndët e pranuar në njësinë organizative ku është punësuar, mban evidenca të sakta dhe me kohë në regjistrin e regjistrimit të lëndëve dhe regjistrin e çregjistrimit të lëndëve sipas kërkesave të specifikuar të vetë regjistrit, kujdesi për lëndët dhe shkresat e lëndëve.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Regjistrin me kohë lëndët në regjistrin e pranimit të lëndëve me të gjitha të dhënat që kërkojnë sipas regjistrit duke mbajtur evidenca të sakta të lëndëve dhe shkresave të lëndës duke e mbajtur edhe evidencën elektronike;

Çregjistrin lëndët dhe mbanë evidenca të sakta në regjistrin përkatës dhe në mënyrë elektronike, mbanë evidenca për lëndë specifike dhe të rëndësishme të veçantë, duke vepruar me vetë-iniciativë dhe pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë;

Përgjegjës për afate dhe saktësi të punës;

Mbikëqyrë sistemin e përcjelljes së lëndëve dhe menaxhon me lëndët sipas punës së ngarkuar;

Kontrollon lëndët dhe lëvizjen e tyre brenda institucionit, duke qenë në gjendje që në çdo kohë ta sigurojë lëndën për përfaqësim në Gjykatë;

Mbanë evidenca të sakta e të plota lidhur me dosjet dhe shkresat e lëndëve, akteve, shkresave dhe dokumenteve tjera zyrtare, përfshirë edhe përgatitjen e raporteve për punën e kryer në periudha të caktuara raportuese;

I gatshëm për kryerjen e çdo detyre tjetër si referent në shkrimore në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale;

Kryen edhe punë tjera të lidhura me punën e referentit të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Shkathtësi të mirë komunikimi me shkrim dhe me gojë;

Aftësi të rregullimit dhe të ruajtjes së kujdesshme të dosjes së lëndëve dhe shkresave;

Aftësi të punojë e pavarur dhe në mënyrë ekipore;

Shkathtësi të mira të punës me kompjuter (Word dhe Excel).

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, Administratë Publike, Shkenca Sociale.

Përvoja e Punës:

Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, duke filluar nga data 30.03.2022 deri me datë 14.04.2022 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org;
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës:** Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vullën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.
- Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:**
 - Dëshminë e kualifikimit shkollor;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);
 - Dy rekomandime (nëse keni);
 - Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
 - Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
 - Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 307/2022 od 15 februar 2022. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljivanje:

KONKURS

I. Viši Referent

Osnovno Tužilaštvo Priština, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 003
Naziv Pozicije: Viši Referent
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesionalni
Radni Kod: DR/850
Raportira kod: Rukovodilac Sektora Pisarnice
Broj Pozicija: Jedna (1) pozicija
Koeficijent: Sedam (7)
Akt imenovanja: Na neodređeno
Probni rad: Dvanaest (12) meseci
Mesto: Priština

Cilj radnog mesta:

Pružna širu administrativnu i tehničku podršku u vezi primljenih predmeta u organizativnoj jedinici gde je zapošljen/a, vodi tačne i blagovremene evidencije u registru za upisanje predmeta i registru za otpisanje predmeta na osnovu specifikovanih zahteva samog registra, vođenje računa o predmetima i spisa predmeta.

Glavne Obaveze i Odgovornosti:

Blagovremeno registruje predmete u registru za prijem predmeta sa svim podacima koji se traže na osnovu registra vodeći tačne evidencije predmeta i spisa predmeta uz uvođenje elektronske evidencije;

Otpisuje predmete i vodi tačne evidencije predmeta u odgovarajućem registru i elektronskim putem, odi evidencije o specifičnim predmetima i onih od posebne značajnosti, postupajući samo-inicijativno i bez direktnog nadzora;

Odgovoran za rokove i radne preciznosti;

Nadgleda sistem praćenja predmeta i upravlja sa predmetima na osnovu radnog opterećenja;

Kontroliše predmeta i njihovo kretanje unutar institucije, uz spremnost da u svakom trenutku obezbedi predmet za zastupanje u Sudu;

Vodi tačne i potpune evidencije u vezi dosijea i spisa predmeta, akata, ostalih službenih spisa i dokumenata, uključujući i pripremanje izveštaja o obavljenom radu u određenim izveštajnim periodima.

Spreman za obavljanje svake druge obaveze kao referent na pisarnici u skladu sa važećim zakonima i propisima;

Obavlja i ostale poslove u vezi sa radom referenta koje se mogu povremeno razumno zahtevati.

Znanje, veštine, sposobnosti za radno mesto:

Dobre pismene i usmene komunikativne veštine;

Sposobnosti za uređivanje i pažljivog sačuvanja dosijea i spisa predmeta;

Sposobnost da radi samostalno i u timskom radu;

Dobre sposobnosti rada kompjuterom (Word i Excel).

Stručna sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma, Pravni Fakultet, Javna Uprava, Društvene Nauke.

Radno Iskustvo:

Najmanje dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 30.03.2022 do 14.04.2022 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte,** koje sadrže poštanski pečat nad pošljikom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu:**Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju. Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu. "Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:**
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues